



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRRI

01 Nr. / Br. 09/25

Nr. i fq. / Br. sf. - 1 -

Data: / Datum 20.01.2025

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **30 janar 2025 (e enjte), me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

R E N D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 26 dhjetor 2024.
2. Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024.
3. Kërkesë për mbështetje financiare për shërim për z.Adem Hasani.
4. Propozim - vendim për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës.
5. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.216/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale në Parkun Industrial në Lumadh.
6. Rishqyrtimi dhe harmonizimi i vendimit me numër të protokollit 01.196/24 i datës 31.10.2024, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, për KEDS-in.
7. Pyetje dhe përgjigje.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 10/25

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 20.01.2025

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrië
PËRMES:	Sekretarisë së Kuvendit
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 20.01.2025

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **20 janar 2025** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2024.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
2. Kërkesë për mbështetje financiare për shërim për z. Adem Hasani.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
3. Propozim - vendim për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.
4. Propozim - vendim për përkrahje financiare për akademik Marenglen Verlit.
Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:
Që të mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E XI E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 DHJETOR, 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:25**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Adnan Lahu, Alban Bajrami, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Gentiana Rama, Gresa Muli, Kushtrim Hyseni, Fakete Dushi, Mek Selaci, Jeton Gjaka, Spasoje Stefanoviç, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Sylejman Mehulli dhe Ymer Haradinaj.

Munguan: Agim Bregaj, Fatmire Cecelia, Nasuf Aliu, Zojë Hajrizi dhe Shkelzen Xhaferi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezentë 30 anëtarë të kuvendit dhe kuorumi është i plotë për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës z. Ferit Idrizi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit – në fillim të mbledhjes njoftoi kuvendin për materialet e pikave që do të trajtohen për shqyrtim në rendin e ditës.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit – në adresimin e tij para anëtarëve të kuvendit në deklaratimet jashtë rendit të ditës deklaroi se, ajo çfarë ka ndodhur kohëve të fundit dhe ato çfarë i ka thënë Lëvizja Vetëvendosje në kuvend dhe në reagime publike dhe mjete juridike të përdoruar në MAPL, është konstatuar se ajo se çfarë ka bërë ky kuvend në mbledhjen e datës 2 dhjetor 2024, ka qenë e kundërligjshme dhe e tillë ka dalë. Tutje vlerësoi se vendosmëria e grupit të LVV-së në kuvend, doli të jetë vendosmëri e duhur, vendosmëri e ligjshme, ndërsa përpjekjet dhe tendencat për t'i gllabëruar dhe rrëmbyer 20 hektarë pronë publike të komunës dolën të jenë të paligjshme, dolën që nuk janë respektuar procedurat dhe janë në kundërshtim me interesin qytetar. Në vazhdim ceku se nuk gjenë fjalë për të përshkruar këtë gjendje, sepse çfarëdo që thotë nuk do të mjaftonte për një Kryetarë Komune i cili edhe në ballafaqim me forcën e ligjit, nuk ndalet, deri sa e detyron MAPL, protesta dhe afishet e qytetarëve dhe për të cilat për një muaj ditë rresht nuk thotë asnjë fjalë të vetme për pasurinë e Komunës në vlerë prej 20 hektarë tokë, dhe më pas kur e humb betejën provon të takoj komunitetin duke provuar të amortizoi dhe kinse nuk ka ndodhur asgjë fare, dhe

po interesohet për interesat e qytetarëve por jo tërheqja e Kryetarit nuk ka ndodhur, por ai është ndaluar dhe është dorëzuar, dhe kjo tërheqje është krejtësisht e pa sigurtë. Më pas ai nga foltorja e kuvendit e sfidoi Kryetarin e Komunës, që të dal të deklarohet se këto prona nuk do t'i sjellë përsëri në kuvend për votim, për dhënie në shfrytëzim, kjo për faktin se këtij kryetari më askush nuk i beson, sepse tërheqja e tij është e përkohshme për kalkulime elektorale për shkak të zgjedhjeve nacionale të 9 shkurtit 2025. Në fund, ai falënderoi çdo qytetarë që ka kontribuar në këtë betejë politike për ta ndaluar këtë maskaradë për gllabërimin e pronës publike të Komunës së Vushtrrisë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –duke iu drejtuar anëtarëve të kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë ceku se në seancën e kaluar u votuan si u votuan disa vendime lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dhe shtoi se ata kishin votuar për një projekt siç është Zona Ekonomike në Lumadh që është një ndër projektet më të mëdha në Komunën e Vushtrrisë, në vitet e pas luftës i hartuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Sa i përket pronave tjera të aprovuar nga ky kuvend, vlerësoi se ato janë votuar nga pothuajse të gjithë anëtarët e kuvendit, e edhe anëtarët e LVV-së të përfaqësuar në kuvend, janë me emra, mbiemra dhe ka edhe video. Lidhja Demokratike e Kosovës, për vendimet e kuvendit të datës 2 dhjetor 2024 ndihet e manipuluar nga kryetari i komunës, duke shpërfillur procedurat ligjore dhe duke mos pasur dëgjime me qytetarët të lokaliteteve ku janë dhënë këto prona. Duke ju adresuar qytetarëve të komunës, vlerësoi se LDK është parti e djathtë dhe është pro bizneseve dhe do ti përkrahin ato sepse janë pro rritjes së bizneseve dhe pro rritjes së vendeve të reja të punës. Por duke respektuar procedurat ligjore dhe kur propozimet vijnë ashtu siç e do ligji. Në fund bëri të ditur se janë disa prona që janë aprovuar atë ditë dhe një pjesë e konsideruar e anëtarëve të LDK-së nuk i ka përkrahur, por janë votuar nga LVV-ja dhe kjo dëshmohej edhe me videon e seancës së kuvendit. LDK-ja është pro-anulimit të këtyre vendimeve.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit dhe i uroj për festat e fund vitit deklaroi se, seanca e datës 2 dhjetor 2024 e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, ishte një shfaqje e shëmtuar, ku Kryetari i Komunës në bashkëpunim me grupin kuvendar të PDK-së dhe LDK-së tentuan të kontrabandojnë 20 hektarë tokë publike, duke ju dhënë pronë komunale personave, grupeve dhe bizneseve të lidhura me këto parti. Lëvizja Vetëvendosje e ka kundërshtuar hapur këtë proces, si në seancë ashtu edhe pas saj dhe po ashtu kemi bërë ankesë në MAPL për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 2 dhjetor 2024. MAPL, bazuar në mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe rregulloren për fushat e përgjegjësisë së ministrisë dhe Zyrës së Kryeministrit, dhe ministria ndër të tjera ka konstatuar me sa vijon: se pas vlerësimit të shtatë (7) pikave shtesë në seancën e datës 2 dhjetor 2024, ministria konstaton se këto vendime janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Duke parë këtë vlerësim negativ të ministrisë për sa i përket këtyre vendimeve dhe kundërshtimin e ashpër të LVV-së në Vushtrri, të qytetarëve dhe bizneseve Kryetari i Komunës u dorëzua. Ju premtuat se këto pika të rendit të ditës do ti sillni prapë në seancën e kuvendit të datës 26.12.2024 dhe më vonë deklaruat se do të tërhiqeni, andaj mendon se ky veprim i kryetarit të komunës është jo i sigurtë, politik dhe i përkohshëm, sepse këto prona do të tentohet që sillen në kuvend në njërin nga seancat e kuvendit në vitin e ardhshëm. Në këtë relacion premtimi i Kryetarit të Komunës më nuk mjafton sepse atij nuk i besojnë më tej qytetarët. Procesi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë i pronës komunale, nga fillimi është përcjellë me parregullsi, jo-transparencë dhe shkelje të procedurave ligjore dhe si qëllim të vetëm ka pasur pasurimin e individëve dhe grupeve të interesit brenda Lidhjes Demokratike dhe Partisë Demokratike të Kosovës. Atë që e kemi thënë në seancën e kuvendit të datës 2 dhjetor 2024 e ka

vërtetuar MAPL, të cilës i jemi mirënjohës dhe falënderues për vlerësimin e drejt dhe meritort të vendimeve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe si i tillë e ka përkrahjen e Lëvizjes Vetëvendosje në Vushtrim dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit –në fillim të diskutimit të tij falënderoi Kryetarin e Komunës, grupin kuvendar të PDK-së, atë të LDK, AAK-së dhe NISMËS, kjo për faktin se me veprimet e tyre njëmend i treguan qytetarëve se kush janë në të vërtetë, që nuk keni asnjë dallim në mes veti, ashtu që kur është puna te prona të gjithë bëhen bashkë për realizimin e interesave të tyre personale e private.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –duke ju referuar disa shprehjeve popullore, vuri në dukje se duke i dëgjuar parafolësit i duket se janë shumë të mençur dhe të guximshëm. Ai potencoi se populli thotë: *<nëse pitja është hëngër tepsia ka mbetur>*, andaj në seancën e datës 2 dhjetor në votim kanë marrë pjesë pothuajse të gjithë, ndërsa nga grupi kuvendarë i LVV-së kanë votuar 33% pro pikave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë. Më tej vlerësoi se nuk është shumë me rëndësi se si është votuar “për”, “kundër” apo “abstenim”, me rëndësi kuorumi është themeluar për t’i kaluar ato vendime. Vlerësimet e bëra nga ana e MAPL-së janë krejtësisht ligjore dhe me vend dhe potencoi se edhe atë ditë kishte tërhequr vërejtjen se pika për Parkun në Lumadh nuk është në rregull, sepse është konstatuar se dy anëtarë të kuvendit nga mandati i kaluar kishin votuar në konflikt të interesit gjë e cila është konstatua nga instancat kompetente. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka vërtetuar se ai vendim në vitin 2021 ishte marrë në kundërshtim me ligjin dhe tani në këtë rast këtë çështje mund ta zgjidhë vetëm gjykata. Ai konsideroi se është shumë e nevojshme që këto prona mos të lihen peng, por kuvendi në suaza të ligjit ti rregulloj ti jap në shfrytëzim që t’iu mundësohet bizneseve të zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Kërkoj nga Kryetari i Komunës që t’ju shkojë deri në fund zbatimit të vendimeve të kuvendit, duke marrë përsipër obligimet ligjore që i ka cekur edhe MAPL, ashtu që t’i shkëput kontratat që kanë qenë joligjore në Parkun Industrial në Lumadh, duke vazhduar me rrjedha të reja ashtu që mos të kemi bllokim të këtij procesi.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-vlerësoi se shkeljet procedurale dhe ligjore që kanë ndodhur në seancën e kaluar, nuk kanë lënë pa pasoja si bizneset ashtu edhe qytetarët e Komunës së Vushtrrisë që shtrihen në lokalitetet që kanë qenë ato prona që u pretendua të jepen në shfrytëzim. Në seancën e 2 dhjetorit 2024 individë të caktuar nga qeveria e kaluar dhe nga qeveria aktuale, bënë pazare të natës për rrëmbimin e tokave të komunës për interesa personale private e klanore. Po ashtu prapë u tentua që të sillen këto vendime për votim për interesa personale, duke shkelur të gjitha procedurat dhe vendimet paraprake të këtij kuvendi, por MAPL-ja ia kthen mbrapsht. Te bizneset apeloj se ato janë viktima të keqmenaxhimit dhe interesave personale të individëve të cilët kanë ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e biznesit. Si përfaqësues i qytetarëve në këtë kuvend gjithëherë ka qenë në mbështetjen e bizneseve, por duke i kundërshtuar keqbërësit që përfitojnë mbi kurrizin tuaj, dhe për këtë situatë fajtorë mbeten individ nga qeverisja e kaluar dhe nga kjo qeverisje, të cilët janë të implikuar direkt në pazaret e natës. Ai ju drejtua kryetarit të komunës se përse nuk po i zbaton vendimet e kuvendit. Në fund pyet kryetarin se përse është prishur rruga në hyrje të qytetit nga rrethi i Emonës, e cila ka qenë ndoshta rruga më e mirë e qytetit, ndërsa aty shihet se nga një kompani e caktuar ajo është frezatur, ai pyeti se cila është logjika e prishjes së kësaj rruge, kur ajo ka qenë në gjendje të mirë, kush është duke punuar cila kompani dhe çfarë mendohet të bëhet dhe ndryshohet në këtë projekt-rrugë. Më tej pse nuk u investua ajo çfarë është proklamuar si kanalizimi fekal dhe atë atmosferik.

Gresa Muli, anëtare e kuvendit-duke ju referuar anëtarit të kuvendit z. Lahu dhe disa anëtarëve të tjerë, vlerësoi se ata janë duke tentuar të iu qesin hi syve qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Ajo shtoj se dëshiron të sqarohet para qytetarëve se personalisht kishte votuar vetëm për një pikë jo edhe për pikat tjera, dhe vlerësoi se ndjen keqardhje, për krejt këtë proces se si ka shkuar. Ajo sqaroi se pika për të cilën ka votuar bëhet fjalë për biznesin “Edona Market” të cilët krejt pasurin e tyre e kanë fituar me mund dhe djersen e tyre, asnjëherë nuk kanë marrë ndihmë as nga shteti e as nga komuna. Mandej njoftoi se dokumentacioni që ka sjellë biznesi “Edona Market” ka qenë larg më i kompletuar se sa i bizneseve tjera dhe kjo tregon se ata kanë qenë serioz në investimet e tyre për zhvillim të biznesit dhe hapjen e vendeve të reja të punës, e që dallon shumë nga bizneset tjera që e kanë shfrytëzuar rastin të përfitojnë pronë në kuadër të këtij procesi duke qenë jo serioz dhe duke hyrë në kalkulim tjera me akter tjerë, pjesë e të cilave nuk ka qenë kurrë dhe as që do të jetë ndonjëherë ajo si përfaqësuese e qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Më tej ajo shtoj se cila nga kompanitë ka pasur plan ideor dhe plan për marrje të huas për zhvillim të projektit përpos biznesit “Edona Market” asnjëra dhe kjo dëshmohet qartë nga dokumentet e dosjes që i janë prezantuar kuvendit. Ajo në vazhdim njoftoi dhe konsideroj se nuk është mirë që një biznes i pastër dhe serioz siç është “Edona Market” të futet në një thes me njerëz dhe biznese tjera fiktive dhe që janë marr me dallavere të, shumta siç edhe ka ndodhur në këtë proces, sepse misioni i këtij biznesi ka qenë investime dhe nuk ka pasur kundërshti përpos fshatit ku ndodhet prona që kanë deklarua gjoja se kanë plane për investime tjera, ndërsa mori si shembull se si që disa vitet një biznesi i janë dhënë në shfrytëzim një pronë e komunës për ngritjen e një fabrike të peshkut, dhe ai investim kurrë nuk ka ndodhur ndërsa ajo pronë akoma nuk i është kthyer komunës si pronare e saj.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit-duke ju referuar diskutimeve të më hershme të anëtarëve të kuvendit, njofton qytetarët se këto diskutime bazohen në dezinformim dhe të bazuara në të pavërteta. Ai sqaroi se me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjet e saj në fuqi, komunat kanë të drejtë dhe obligim të japin pronën në shfrytëzim për biznese qoftë për peronat fizik apo peronat juridik, në mënyrë që të krijohet një klimë dhe kushte më të favorshme për të bërit biznes dhe zhvillimi ekonomik dhe hapja e vendeve të reja të punës, është fokusi qendror për dhënien e pronës në shfrytëzim. Tutje shtoi se si kryesues i komisionit për verifikimin e pronave, ka hartuar tri raport dhe në saje të atyre raporteve, ku janë identifikuar pronat e uzurpuara, ka ardhur deri tek dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim. Në një logjik tjetër kjo do të nënkuptonte se këtyre bizneseve që i kanë plotësuar kushtet tu mohohet e drejta për marrje të pronës, ndërsa tu jepet mundësia uzurpatorëve që vazhdojnë shfrytëzimin e atyre pronave edhe më tej siç ka qenë deri me tash. Nuk ka ligj që e ndalon dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, u fol se e kanë mbrojtur pronën komunale, por nga kush e kanë mbrojtur? Kur po flitet për vlerësimet e MAPL-së edhe këtu po mashtrohet opinioni, sepse ministria nuk i ka shfuqizuar këto vendime për pronë, por vetë ka kërkuar rivlerësim për shkak të procedurave të afateve për dërgimin e materialeve d.m.th. për mos respektim të procedurave, por këto pika mund të procedohen sot dhe të njëjtat të aprovohen. Në vazhdim ceku se në vendet e zhvilluar prona jepet në shfrytëzim edhe për 1 € me qëllim të zhvillimit ekonomik. Ai pyeti se a e dini se vetëm për këto katër vitet e fundit 200,000.00 njerëzi kryesisht të rinj e kanë lëshuar Republikën e Kosovës, dhe jemi një gjendje jashtëzakonisht të rëndë. Në fund tha se është hipokrizi të deklarohet, se jen i për ti mbështetur bizneset e në fund të kundërshtosh dhënin e pronës komunale për ato biznese, andaj ai deklaroj se gjithmonë do të jetë pro dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, zhvillimit të bizneseve dhe zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-në fillim të diskutimit të tij uroj të gjithëve festat e fund vitit dhe po ashtu ju uroj mirëseardhje bashkatdhetarëve tanë nga diaspora që kanë ardhur në vazit tek familjet e tyre. po ashtu iu uroj sukses në zgjedhjet nacionale kandidatëve për deputet në Kuvendin e Kosovës. Lidhur me vendimet për dhënien e pronës në shfrytëzim deklaroi se nuk po di akoma

se kush e ndali këtë proces Sylejman Mehulli, Refik Malok apo Ymer Haradinaj. Por ajo çfarë është e dëmshme është fakti se procesi i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim është duke u lënduar, deh kjo është pengesë për zhvillimin ekonomik lokale, sepse pa pronë nuk ka hapej të biznesit dhe vende të reja të punës. Nëse duam të shohim përparim atëherë duhet ti shikojmë komunat përreth p.sh. Komuna e Drenasit e ka hapur parkun e dytë industriale. Nëse dëshirojmë të kemi sukses në zhvillimin e bizneseve nuk duhet të funksionojmë në mënyrë parciale dhe të shërbehemi me gjysmë të vërteta. Më tej shtoj se biznese janë duke u ngulfatur kjo si pasojë e pengesave politike dhe burokracisë. Lëvizja Vetëvendosje e kishte ndal edhe penguar edhe çështjen e objektit të ish-Gjykatës Komunale, objekt i cili është shndërruar në çerdhe të narkomanëve. Pastaj duke ju referuar anëtari të kuvendit z.Haradinaj, ceku se përse nuk e ka ndalur ndërtimin e fabrikës në objektin e shkollë në Stanoc i cili kundërligjshme ishte aprovua në mandatin e kaluar, dhe vlerëso se gara mes këtyre anëtarëve të kuvendit është kush po e merr primatin. Lidhur me problemin e Parakut Industrial në Lumadh, ceku se ish kryetari i komunës z.Tahiri, kishte bërë fushatë të pandershme duke propaganduar se kryetari aktual i komunës është duke i bllokuar bizneset, ndërsa për këtë arsye këtë vendim e kishte sjellë sërish për votim. Më tej shtoj se procesi gjyqësor lidhur me pronat në Parkun Industrial në Lumadh është duke vazhduar dhe këtë e dëshmon aprovimi i ankesë nga ana e Gjykatës së Apelit. Kjo për faktin se procesi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale në Parkun Industrial në Lumadh ishte përcjellë me parregullsi dhe keqpërdorime të shumta dhe me lidhje të kontratave të kundërligjshme duke ju mundësuar firmave që ta shesin pronën e komunës që e kanë marrë në shfrytëzim, kjo është konstatuar nga MAPL dhe Agjencia Kundër Korrupsion, këtë mesazh dua të ja përcjellë ish kryetarit të komunës Xhafer Tahiri. Lidhur me çështjen e Rr. “Dëshmorët e Kombit” sqaroi se një pjesë e asaj rruge do të mund të rezistonte kohës, por një pjesë ka qenë e dëmtuar, është bërë pastrim i kanalizimit atmosferik dhe në pjesën tjetër do të ndërtohet kanalizimi. Ky projekt është në kuadër të bashkëfinancimit me Ministrinë e Infrastrukturës dhe nuk ka dashur ti humbë mjetet nga ky projekt. Në fund deklaroi se zotohet se këto pika për këto prona nuk do të sillen serish në kuvend për aprovim. Po ashtu deklaroi se i qëndron zotimit të tij para qytetarëve dhe propozon që pikat lidhur me pronën të tërhiqen dhe të njëjtat të shfuqizojnë pesë vendimet që ishin aprovuar në seancën e datës 2 dhjetor 2024 për pronat komunale.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –deklaroi se është kryetar i qendrës së LVV-së në Vushtrri dhe shef i grupit kuvendar të kësaj partie, dhe askush këtë nuk mund ta lajthitë. Ai potencoi se është ai dhe grupi kuvendar i tij të vetmit që i kanë ankimuar vendimet e kuvendit të datës 2 dhjetor 2024 lidhur me pronat e komunës dhe për këtë janë krenar që kanë arritur ta shpëtojnë pronën komunale nga keqbërësit që tentuan ta gllabërojnë këto toka. Më tej përsërit se nuk janë kundër bizneseve, por nuk bëjnë kompromis me ligjin, grupi kuvendar i LVV-së vjen në kuvend për interesin e përgjithshëm qytetar tjetër interes nuk njohin. Edhe seancën e kaluar kishin tërhequr vërejtjen se është duke u lënduar ligji, duke u shkelë parimet dhe proceduar që cakton ligji dhe kjo është konstatuar katërçipërisht nga MAPL-ja. Lidhur me çështjen e investimeve vlerësoi se komuna, konkretisht kryetari i komunës, për një lokal prej 20 m² i ka akorduar takës mujore prej 275 €, ndërsa tentoj ti jap në shfrytëzim pronë komunale prej 30 ari për vetëm 125 € për muaj, dhe për çfarë politikash të përkrahjes së biznesi po flasim. Grupi kuvendar i Lëvizjes Vetëvendosje i mbështet plotësisht propozimet për tërheqjen dhe anulimin e këtyre vendimeve, sepse absolutisht forma se si janë votuar këto vendime ka qenë në kundërshtim flagrantë me ligjin.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –duke ju kundër përgjigjur anëtarit të kuvendit z. Mehulli, tha se nuk dëshiron të merret me këta, sepse tek e fundit edhe LDK edhe LVV në Vushtrri janë në opozitë. Por e vërteta është se nga 9 anëtarë sa i ka LVV në kuvend 5 prej tyre kanë qenë të shitur tek

pushteti dhe ata kanë kryer favore prej pushtetit sepse janë punësuar dhe ata vazhdimisht e kanë mbështetur pushtetin me votën e tyre në kuvend për këto 3 vite. Prandaj LVV nuk mund të na shet moral sepse edhe në seancën e kaluar kanë votuar për këto vendime, dhe ata nuk mund të nda tregojnë se cilat biznese janë të mira e cilat jo. Në fund deklaroi se LDK në Vushtrri është pro anulimit të këtyre vendimeve, dhe ceku se në një rast tjetër ata janë pro që këto biznes të ndihmohen duke i respektuar procedurat ligjore.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese kuvendit-në mënyrë taksative i propozoi vendimet nga seanca e kaluar e datës 2 dhjetor lidhur me pronat komunale, që të futen në rendin e ditës për shfuqizim, konform renditjes dhe konstatimit të numrave të protokollit të këtyre vendimeve të cekura si më poshtë në rendin e ditës.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit në mënyrë individuale i hodhi në votim propozimet për shfuqizim të vendimeve lidhur me pronat komunale të aprovuara në seancën e datës 2 dhjetor 2024 dhe atë si në vijim:

Kuvendi pas votimit me 29 vota “për” aprovoj për inkomporim në rendin e ditës propozimin e kryetarit për të komunës për shfuqizimin e Vendimit me numër të protokollit Nr.211/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadasterale P-70202016-00001-1 ZK-Vushtrri, përfituese BY KOS L.LC.

Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” 2 vota “abstenim” aprovoj për inkomporim në rendin e ditës propozimin e kryetarit për të komunës për shfuqizimin e Vendimit me numër të protokollit Nr.212/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadasterale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Edona Company L.L.C.

Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 2 vota “abstenim” aprovoj për inkomporim në rendin e ditës propozimin e kryetarit për të komunës për shfuqizimin e Vendimit me numër të protokollit Nr.213/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadasterale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Elektro Plus SH.P.K.

Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 2 vota “abstenim” aprovoj për inkomporim në rendin e ditës propozimin e kryetarit për të komunës për shfuqizimin e Vendimit me numër të protokollit Nr.214/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadasterale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Timber Home SH.P.K.

Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 2 vota “abstenim” aprovoj për inkomporim në rendin e ditës propozimin e kryetarit për të komunës për shfuqizimin e Vendimit me numër të protokollit Nr.215/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadasterale P-70202016-001129-1 ZK-Vushtrri, përfituese Dallku AM.SH.P.K.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi para kuvendit, se MAPL, ka dhënë verdiktin e saj, e cila është mjaftë koncize dhe në mënyrë taksative ka kërkuar që të veprohet në përmbushjen e

obligimeve ligjore në shkëputjen e kontratave që janë lidhur në vitin 2021 e të cilat bien ndesh me ligjin, kjo është kështu dhe nuk beson se kjo çështje tani i takon kuvendit të komunës për ndërmarrjen e ndonjë veprimi.

Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për”, 1 votë “abstenim”, aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 2 dhjetor 2024.
2. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.211/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-00001-1 ZK-Vushtrri, përfituese BY KOS L.L.C.
3. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.212/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Edona Company L.L.C.
4. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.213/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Elektro Plus SH.P.K.
5. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.214/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Timber Home SH.P.K.
6. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.215/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-001129-1 ZK-Vushtrri, përfituese Dallku AM.SH.P.K.
7. Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.
8. Draft-Plani i Punës i Kryetarit – Qeverisë Komunale për vitin 2025.
9. Draft-Kodi Komunal i Etikës.
10. Draft-Plani Komunal për Transport Lokal Publik të Udhëtarëve, 2024 – 2028.
11. Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë.
12. Raporti i Punës nga Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Vushtrri, për vitin 2024.
13. Propozim-vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025.
14. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 2 dhjetor 2024.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me vota “unanime” miratoi Procesverbalin nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 2 dhjetor 2024.

2. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.211/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-00001-1 ZK-Vushtrri, përfituese BY KOS L.L.C.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 28 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 211/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të Komunës, Pjesë nga Parcela Kadastrale Nr. P-70202016-00001-1 në Zonën Kadastrale Vushtrri përmes Shprehjes së Interesit, BY KOS L.L.C. në Vushtrri.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

3. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.212/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Edona Company L.L.C.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 27 vota “për” 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 212/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të Komunës, Pjesë nga Parcela Kadastrale Nr. P-70202028-00412-1 në Zonën Kadastrale Stanoc i Poshtëm përmes Shprehjes së Interesit, Edona Company L.L.C. në Vushtrri.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

4. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.213/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Elektro Plus SH.P.K.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 28 vota “për” 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 213/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të Komunës Pjese nga Parcela Kadastrale Nr. P-70202028-00412- 1 ne Zonën Kadastrale Stanoc i Poshtëm përmes Shprehjes se Interesit, Electro Plus SH.P.K në Vushtrri.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.214/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202028-412-1 ZK-Stanovc i Poshtëm, përfituese, Timber Home SH.P.K.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 27 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 214/24 i datës 02.12.2024 për **dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të Komunës, Pjesë nga Parcela Kadastrale Nr. P-70202028-00412-1 në Zonën Kadastrale Stanoc i Poshtëm, përmes Shprehjes së Interesit, Timber Home SH.P.K.**

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shfuqizimi i Vendimit me numër të protokollit Nr.215/24 i datës 02.12.2024 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-001129-1 ZK-Vushtrri, përfituese Dallku AM.SH.P.K.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 27 vota “për” 2 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr. 215/24 i datës 02.12.2024 për **dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të Komunës, Pjesë nga Parcela Kadastrale Nr. P-70202016-01129-1 në Zonën Kadastrale Vushtrri përmes Shprehjes së Interesit, Dallku AM. SH.P.K në Vushtrri.**

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –njoftoi kuvendin se ka qenë anëtar i komisionit për hartimin e këtij plani, dhe takimin që e ka pasur komisioni, ka munguar përfaqësuesi i LDK-së, në këtë komision, ndërsa firma e tij figuron në këtë draft-plan, ndonëse ka mungua nga mbledhja. Më tej shtoj dhe propozoi që të bëhet një ndryshim tek muaji dhjetor, ku është informatë nga Njësia e Zjarrfikësve, që është edhe sot në rend dite për shqyrtim, por duhet të emërohet si informatë për periudhën janar-nëntor, e jo si informatë vjetore, apo e njëjta të bartet për vitin e ardhshëm duke e cilësuar si informatë vjetore.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-propozoi që tek muaji shkurt të hiqet nga plani propozim-vendimi për ndarjen e subvencioneve, sepse kjo bëhet në kuadër të aprovimit të buxhetit. Ndërsa tek muaji mars të hiqet nga plani Informata për mbrojtën e pyjeve, sepse kjo çështje tashmë është kompetencë e Agjencisë për Mbrojtjen e Pyjeve.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi me 21 vota “për” aprovoj Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

8. Draft-Plani i Punës i Kryetarit – Qeverisë Komunale për vitin 2025.

9. Draft-Kodi Komunal i Etikës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit, pas shqyrtim dhe votimit me 19 vota “për” aprovoj Kodin Komunal të Etikës të Komunës së Vushtrrisë.

10. Draft-Plani Komunal për Transport Lokal Publik të Udhëtarëve, 2024 – 2028.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –tha se në këtë plan thuhet se Komuna e Vushtrrisë ka, gjithsejtë 899 km rrugë, ku 65% e tyre janë të shtruara, ndërsa 317.2 km apo 35% të rrugëve janë të pa shtruara. Në këtë rast më mirë do të ishte të thuhet se këto rrugë janë të asfaltuara se sa të shtruara edhe pse kjo e dhënë apo statistikë a përkon me realitetin. Në faqen nr.5 thuhet përmendet stacioni i autobusëve, por Komuna e Vushtrrisë nuk ka stacion të autobusëve dhe pyeti se qeveria komunale a ka ndonjë plan për ndarjen e ndonjë parcele për vendosjen e stacionit të autobusëve, më mirë se sa pronën ta marrin oligarkët e partisë në pushtete. Tek faqja 8 ceket se Komuna e Vushtrrisë përbëhet prej 66 fshatrave që jemi dakord, por askund nuk cekën lagjet urbane të qyteti që janë 8 lagje urbane. Në fund pyeti Drejtorin e Shërbimeve Publike se plani a bazohet në statistikave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 apo ato të vitit 2024 sepse në disa vende plani i referohet statistikave të vitit 2011 për numrin e ekonomive familjare dhe numrin e bizneseve e në disa raste të dhënave të vitit 2024.

Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së-paraqiti sqarime lidhur me planin, duke shtuar se ky plan i referohet disa dokumenteve strategjike të planifikimit komunal, si Plani Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale që janë në procedurë të hartimit si dhe Planit të Mobilitetit i cili do të hartohet gjatë vitit 2025. Ndërsa sqaroi se plani bazohet në statistikave të vitit 2011 të regjistrimit të popullsisë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit, pas shqyrtim dhe votimit me 20 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim miratohet Plani Komunal i Transportit Publik Lokal të Udhëtarëve 2025-2029.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Inspektimeve dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

11. Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë

12. Raporti i Punës nga Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Vushtri, për vitin 2024

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –pasi i falënderoj zyrtarët nga Njësia e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Vushtri, kërkoj që në informatë e ardhshme të përfshihen statistika edhe për numrin e punëtorëve në këtë njësi dhe për mjetet e punës që i kanë dispozicion.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –kërkoj nga qeveria komunale, që ti dalë në mbështetje kësaj njësie me mundësitë që i ka, ashtu që kjo njësie e zjarrfikëseve të mund të ofroj edhe auto-cisternën për ujë të pijes aty ku ndihet nevoja për qytetaret e Komunës së Vushtrrisë.

13. Propozim-vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –vlerësoi se kjo listë nuk duhet të publikohet, për faktin se ko listës e pronave duhet të bazohet në Plani Zhvillimor Komunal, dhe për derisa si komunë nuk e kemi të aprovuar këtë plan atëherë as kjo listë nuk duhet të publikohet.

Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-paraqiti sqarime lidhur me listës e pronave, duke shtuar se kjo listë e pronave bazohet në PZHK-në 2020-2024, dhe kjo listë është sipas kornizave ligjore.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit –tha se është e vërtet se është obligim ligjor të publikohet kjo listë e pronave, por nuk duhet harruar se obligim ligjor është edhe dhënia e pronave në shfrytëzim me qëllim të zhvillimit të biznesit e jo të pengohen ato.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit, pas shqyrtim dhe votimit me 19 vota “për”, 1 votë “kundër” 6 vota “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për publikimin e Listës së pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025.

2. Pronat e përshkruara në listë mund të jepen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve të tjera të planifikimit.

3. Me qëllim të nxitjes të zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës në harmoni me planifikimet e komunës, Komuna e Vushtrrisë në të ardhmen planifikon

të jep në shfrytëzim pronën e komunës dhe në varësi nga interesi publik të zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e pronave të Komunës së Vushtrrisë për dhënien në shfrytëzim për vitin 2025.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

15. Pyetje dhe përgjigje.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit –pyeti Kryetarin e Komunës se deri ku kanë shkuar procedurat për ish-objektin e shkollës fillore “Migjeni” në Stanofc të Epërm, për shndërrimin në çerdhe sipas vendimit të kuvendit. Më tej pyeti se deri ku ka shkuar realizimi i premtimit të Kryetarit të Komunës, për pagesën e disa mjeteve financiare sipas obligimeve nga Kontrata Kolektive e Arsimit, ku komuna e Vushtrrisë ka bërë marrëveshje që me tri këste të paguhen obligimet për mësimdhënësit e Komunës së Vushtrrisë, kësti i muajit tetor është paguar ndërsa për muajin dhjetor nuk është kryer pagesa. Ndërsa pyetja e tretë ka të bëjë se cila është arsyeja e mos pagesës për bujqit vlera e shumës së subvencionimit prej 0.5 cent në litër të qumështit për vitin 2024.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se, me që jemi në fund të vitit, kemi informata se nuk janë paguar subvencionet për fëmijët e porsalindur në vlerë prej 120 € sipas vendimit të kuvendit. Ai i bëri thirrje Kryetarit të Komunës që meqë jemi në fund të vitit buxhetor të përmbushen këto pagesa.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- sqaroi se në fillim të vitit 2025, do të startojmë me renovimin e ish-objektit të shkollës “Migjeni” për bërë çerdhe sipas zotimeve që i kemi marr. Lidhur me pagesat që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, sqaroi se mjetet janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe shpejt do të ekzekutohen këto pagesa. Por në këtë rast edhe njëherë ripotencoi se Komuna e Vushtrrisë është dëmtuar jashtëzakonisht shumë nga kjo kontratë ku deri tash janë marrë afër 6 milionë, që është shumë e papërbalueshme për komunën. Këto obligime kanë ndikuar edhe në vonesat në pagesat e subvencioneve për fermerët për 0.5 cent për litër qumështi. Por u zotua se këto pagesa të subvencioneve për bujqit do të kryhen sepse është bërë rritja e fondit të subvencioneve, por do të paguhen edhe subvencionet për fëmijët e porsalindur. Në fund me rastin e fundi vitit, të gjithëve ju uroj festën e Vitit të Ri, duke ju dëshiruar shëndet e suksese.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATA/DATUM/DATE	09.01.2025
PËR/ZA/TO:	Komiteti për Politik dhe Financa-Kuvendin Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetarit të Komunës z. Ferit Idrizi
Nga/OD/FROM	Isuf Jashari, Drejtor i Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2024

Të nderuar

Duke u bazuar në planin e punës për vitin 2024 Drejtoria për Buxhet, Thesar dhe Financa ju prezanton Raportin Janar-Dhjetor 2024 ,Raporti është i bazuar në planin buxhetor dhe planin e rrjedhës së parasë publike për vitin 2024.

Shtojcë:

Raportet fizike

Emri i Komunës :	K.K.VUSHTRRI					
Kodi i Komunës:	644					
Periudha raportuese	Janar - Dhjetor 2024					
TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK						
	12 Komuna :Vushtrri	Planifikimi mujor	Realizimi	Realizimi		
	644	Janar - Dhjetor	Janar-Dhjetor	Janar-Dhjetor	%	%
	Pershkrimi	2024	2023	2024		
	N/R	1	2	3	3:1	3:2
Administ	1 Admin.	120,000.00	71,610.00	29,466.50	24.56	41.15
rata	2 Ndrim emri mbiemri			6,588.00	#DIV/0!	#DIV/0!
Totali	Administ	120,000.00	71,610.00	36,054.50	30.05	50.35
	4 Taksat e firmave	15,000.00	15,000.00	19,500.00	130.00	130.00
	5 Tatimi në pron.	1,333,507.00	1,268,599.19	665,332.15	49.89	52.45
	6				#DIV/0!	#DIV/0!
Totali	Buxhet	1,348,507.00	1,283,599.19	684,832.15	50.78	53.35
	7 Shitja.produ.bujqso.		908.83	450.00		49.51
	8 Participimi Q.Fëmi.	70,000.00	67,759.00	114,634.00	163.76	169.18
	9 Shkolla SHMT	14,000.00	22,809.00	30,508.00	217.91	133.75
	10 Shkolla SHMP	15,000.00	17,970.00	17,055.00	113.70	94.91
Totali	Arsimi	99,000.00	109,446.83	162,647.00	164.29	148.61
	12 RDPP ,Dalja ne terer	70,000.00	141,911.83	94,459.00	134.94	66.56
	16 Qiraj nga objekti pu	53,000.00	18,987.21	47,569.05	89.75	250.53
Totali	Gjeodezi Kataster	123,000.00	160,899.04	142,028.05	115.47	88.27
Kultur	17 Palestra sportive	500.00	624.00	389.00	77.80	62.34
.Rini.Spo	18 Bibloteka M-.L.k-Sm	500.00	121.00	36.00	7.20	29.75
rt	19 Shtepia e Kultures	500.00			-	#DIV/0!
Totali	Kultur	1,500.00	745.00	425.00	28.33	57.05
	20 Ndalja e vet.rrugë	3,000.00	2,030.00	1,711.50	57.05	84.31
	Regjistrmi l automje	140,000.00	151,591.50	170,080.00	121.49	112.20
	21 Taksat e Mbeturuna	846,000.00	543,037.83	694,460.46	82.09	127.88
Totali	Sherbimet Publike	989,000.00	696,659.33	866,251.96	87.59	124.34
Prokurim	22 Tender				#DIV/0!	#DIV/0!
	Shitja e druve			413.08		
	Prokurimi			413.08	#DIV/0!	#DIV/0!
	23 Ndrim.tok.B.	15,000.00	77,902.70	140,228.55	934.86	180.00
	24 Leje pune		60.00	90.00	#DIV/0!	150.00
Totali	Ekonomi	15,000.00	77,962.70	140,318.55	935.46	179.98
	25 Particip.D.shënd.	60,000.00	56,065.23	61,273.00	102.12	109.29
	Qendra.per pun.soc	2,000.00	3,975.00	4,946.00	103.24	124.43
Totali	Shendetësi	62,000.00	60,040.23	66,219.00	106.80	110.29
	26 Donacion			5,108.00		
Drj.e	27 Pranimet Teknike	5,000.00	8,070.00	14,201.50	284.03	#DIV/0!
Inspekzio	28 Pelqime sanitare				#DIV/0!	#DIV/0!
nit	29 Gjobat e inspektion	5,000.00	7,600.00	5,916.30	118.33	77.85
Totali	Inspeksioni	10,000.00	15,670.00	20,117.80	201.18	201.18
	30 Leje Ndertimi	560,147.00	771,491.23	754,079.57	134.62	134.62
	31 Leje mjedisore	70,000.00	113,076.90	90,092.55	128.70	79.67
	32 Legalizimi I Objektev	15,000.00	25,663.86	9,430.28	62.87	36.75
	33 Rrenimi I objektit		852.60	412.44	#DIV/0!	48.37
	34 Shf.prones publike	5,000.00	10,977.50	839.50	16.79	7.65
Totali	Urbanismi	650,147.00	922,062.09	854,854.34	131.49	92.71
	35 Denimet e Policis			298,157.50	#DIV/0!	#DIV/0!
	36 Gjobat e trafikut			33,250.00	#DIV/0!	#DIV/0!
18	37 Gjobat e Pyjeve			223.00		
	38 Të hyrat tjera		6,467.28	1,791.00	#DIV/0!	27.69
Totali		3,418,154.00	3,405,161.69	3,307,582.93	96.77	97.13
Sqarim:Planifikimi I të Hyrave Vetanake për vitin 2024 është 3,418,154.00euro,Realizimi është 3,307,582.93euro						
Realizimi në përqindje është 96.77%						

#REF!	K.K.Vushtri																		
#REF!	644																		
Periudha raportuese	Janar - Dhjetor 2024																		
PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT																			
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDDHA RAPORTUESE			VILETORE			Viti I kaluar											
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nukteit të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2024	Buxheti I mbetur për 2024	Plani i reviduar 2024	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2023										
	4	5	6 = 5/4*100 %	7	8=7-5	9	10 = 7-9	11											
		€	€	%	€	€	€	€											
Finacimi nga huamarrjet	04			0%	0.00	0.00	0.00	0.00											
Granti Qeveritar	10	24,380,000.61	23,348,947.44	96%	24,380,000.61	1,031,053.17	0.00	24,380,000.61											
Të hyrat vetanake	21	3,418,154.08	2,754,622.36	81%	3,418,154.08	663,531.72	0.00	3,418,154.08											
Mjetet e bartura	22	1,560,105.42	1,367,309.46	88%	1,560,105.42	192,795.96	0.00	1,560,105.42											
Donacionet e brendshme	31	5,623.23	2,000.00	36%	5,623.23	3,623.23	0.00	5,623.23											
Donacionet e jashtme	32	24,794.17	12,395.71	50%	24,794.17	12,398.46	0.00	24,794.17											
TOTALI		29,388,677.51	27,485,274.97	94%	29,388,677.51	1,903,402.54	0.00	29,388,677.51											
Sqarim:																			
Sqarim:Përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit sipas kategorive ekonomike është si vijon:																			
Granti Qeveritar për periudhën Janar-Dhjetor 2024,planifikimi është 24,380,000.61euro.Realizimi është 23,348,947.44eur,përqindja e realizimit 96%																			
Kategoria Të Hyrat vetanake Fondi 21 për periudhën Janar-Dhjetor 2024, planifikimi është 3,418,154.08 euro,Realizimi i shpenzimit shuma 2,754,622.36euro.																			
Shprehur në përqindje realizimi është 81%																			
Kategoria Të Hyrat vetanake Fondi 22 për periudhën Janar-Dhjetor 2024, planifikimi është 1,560,105.42 euro,Realizimi i shpenzimit shuma 1,367,309.46euro.																			
Shprehur në përqindje realizimi është 88%																			
Donacionet e brendeshme dhe Donacionet e jashtme planifikimi 5,623.23euro,realizimi 2,000.00euro,shprehur realizimi 36%																			
Donacionet e jashtme planifikimi 24,794.17euro,realizimi 12,395.71euro,shprehur realizimi 50%																			
Planifikimi total sipas burimeve të financimit është shuma 29,388,677.51euro.Realizimi është 27,485,274.97euro .Përqindja e realizimit 94%																			

Komuna	VUSHTRRI	PERIUDHA RAPORTUESE		VITORE				Viti i kaluar		
Kodi	644	BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e muxhetti të alokuar	Buxheti i planifikuar për 2024	Buxheti i mbetur për 2024	Plani i reviduar 2024	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë të 2023	
Periodha raportuese	Janar - Dhjetor 2024	4	5	6 = 5/4*100 %	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11	
PËRMLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE		€	€	%	€	€	€	€	€	
PËRSHKRIMI	KODI									
Paga dhe mëditje	111	14,270,146.65	14,268,928.57	100%	14,270,146.65	1,218.08	0.00	14,270,146.65	12,141,455.83	
Mallra dhe shërbime	130	5,122,737.49	4,932,681.87	96%	5,122,737.49	190,055.62	0.00	5,122,737.49	4,419,302.10	
Shpenzimet komunale	132	580,268.14	486,810.28	84%	580,268.14	93,457.86	0.00	580,268.14	447,458.24	
